




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT
PËR HARTIMIN E PROJEKT-RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË
DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SË NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Projekt-Rregullorës për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak së një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:

1. Vlora Krasniqi, Shefe në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore, kryesuese
2. Lumnije Ejupi, Shefe në Sektorin për çështje juridiko-pronësore, anëtare
3. Islam Kaleshi, Zyrtar ligjor në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
4. Gafurr Hetemi, Zyrtar në Sektorin për çështje juridiko-pronësore, anëtar
5. Rafete Retkoceri, Zyrtare ligjore në Drejtoratin për Shërbime Publike, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të hartoj Projekt-Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim më pak së një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, konform dispozitave të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/2019), nenit 7 të Rregullores nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe në pajtim me dispozitat tjera ligjore, më së largu deri me 20.11.2020.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 463-53773
Lipjan, më 02-11-2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

